

SHBA dhe Kosova: Nga të Drejtat e Njeriut te Pavarësia

*Dr. Samet Dalipi**

Përmbledhje

Opinionit intelektual amerikan lidhur me Kosovën është përcjellë dhe vazhdon të përcillet me vëmendje të theksuar nga qytetarët dhe politikbërësit e Kosovës. Qëndrimet e tyre kanë shërbyer e vazhdojnë të shërbejnë si indikatorë shumë të rëndësishëm të zhvillimeve për të ardhmen e saj. Ky kujdes i opinionit kosovar ndaj reflektimeve amerikane lidhur me Kosovën është rezultat i pragmatizmit amerikan në afirmimin e vlerave lirisdashëse dhe promovimit të demokracisë në botë nga ky vend.

Shkatërrimi i përgjakshëm i ish Jugosllavisë ishte një shtytje për një kujdes më të shtuar nga bashkësia ndërkombëtare, e sidomos nga SHBA-t, në moslejimin e edhe të një tragjedie njerëzore, e cila do të rëndonte ndërgjegjen e politikbërësve të kohës.

Shqiptarët për dhjetë vite rezistuan paqësisht kundër nacionalizmit ekspansionist serb, por zëri i tyre, përkundër simpative, nuk mjaftoi për të tërhequr kujdesin e duhur ndërkombëtar pa hyrë në ciklin e dhunës ndëretnike.

Dukej se një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare kishte iluzion vazhdimin e qëndrimit të ish federatës, ashtu siç do të konsideronte edhe mundësinë e gjetjes së zgjidhjes së çështjes së Kosovës brenda një mbetjeje serbo-malazeze, apo më vonë brenda Serbisë.

Pavarësinë e tyre, kombet e ish Federatës Jugosllave, e paguan me humbjen e qindra mijëra jetëve, si pasojë e të udhëhequrit nga mitet e besëtytnitë e trilluara mesjetare, mbi të cilat u formësua ideologjia serbomadhe, pararojë e së cilës do të qëndrojë Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë.

Në këtë punim do të paraqitet opinionit zyrtar politik e akademik i SHBA-ve lidhur me politikën amerikane për Kosovën para, gjatë dhe pas luftës, si dhe nga dokumentacioni i publikuar do të vërehet një evoluim substancial i qëndrimit karshi zgjidhjes së çështjes së Kosovës.

Fjalët kyç: Ndërtimi i paqes, intervenimi humanitar, multikulturalizmi, ndërhyrja humanitare.

* *Dr. Samet Dalipi, Universiteti AAB, Prishtinë. E-mail: samet.dalipi@aab-edu.net*

Interesimi Amerikan për Kosovën

Angazhimi serioz i Amerikës lidhur me Ballkanin ishte kujdesi i Woodrow Wilson-it¹, nëpërmjet "14 pikave" të 6 janarit 1918, duke arsyetuar lënien pas të izolacionizmit të SHBA-ve në Luftën e Parë Botërore, me arsyet morale dhe të mbrojtjes së paqes në Evropë dhe të vlerave progresive. Wilson angazhohej për një diplomaci të hapur, të drejtën e vetëvendosjes,² krijimin e lidhjes së kombeve, për siguri kolektive e jo të bazuar mbi ekuilibrin e forcave. Pas Luftës së Dytë Botërore ndikimi, i tashmë superfuqisë, ishte vendimtar në përpjekjet për të promovuar vlerat e demokracisë karshi ideologjive diktatoriale moniste. Rënia e perdes së hekurt, e diktaturave komuniste në Evropën Lindore dhe vendosja e demokracive ishte rezultati kulmor i investimeve të demokracive perëndimore, por edhe të erupsionit të nacionalizmave të ndrydhur nga sistemet moniste, të cilët quan deri te shpërthimet e konflikteve, të cilat rezultuan me akte gjenocidale, shkatërrime në masa njerëzore e ekonomike. Në situatë të këtillë, gjatë dy dekadave të fundit, të gjitha administratat në Uashington kanë qenë të pozicionuara në ndaljen e vuajtjeve njerëzore të shkaktuara nga luftërat dhe të ndajnë barrën me komunitetin evropian për rindërtimin dhe vendosjen e paqes në regjion. Më tej, Shtetet e Bashkuara kanë qenë në "luftë" në mes pacenueshmërisë së kufijve shtetërorë (princip i njohur në Kartën e KB dhe Aktin e Helsinkit) dhe idealit të vetëvendosjes, i cili "ka qenë gjerësisht i interpretuar si e drejtë e minoriteteve për vetëqeverisje qoftë edhe për shtetëformim".³ Interesimi i SHBA-ve për Ballkanin pas Luftës së Dytë Botërore ishte konform rrjedhave të luftës së ftohtë, derisa interesimi për

¹ Lisen Bashkurti, *Negociatat, historia, teoria, praktika*, Tiranë, GEER, 2007, faqe 91.

² „Ne besojmë në këto gjëra fundamentale: e para, që cdo popull ka të drejtë të zgjedhë sovranitetin brenda të cilit ata do të jetonin...” Woodrow Wilson: "Address delivered at the First Annual Assemblage of the League to Enforce Peace: "American Principles", May 27, 1916. Online by Gerhard Peters and John T. Woolley, The American Presidency Project. <http://www.presidency.ucsb.edu/ws/?pid=65391>. Qasja, 3 shkurt 2012.

³ Luic Poulain and Ilona Teleki, *U.S. Policy Toward the Western Balkans*. Faqe 26. Në ed. Janusz Bugajski, *Western Balkans Policy Review 2010*, Center for Strategic & International Studies, 2010.

Jugosllavinë rritej, për shkak të politikës refuzuese të Titos ndaj Stalinit dhe qëndrimit neutral të tij ndaj blloqeve, politika shqiptare bëri që marrëdhëniet mes dy shteteve të arrijnë deri aty që SHBA të tërheqë misionin diplomatik nga Tirana(1946) dhe të angazhohet kundër Shqipërisë për pranimin e saj në KB. Politika amerikane ndaj Jugosllavisë si një zonë puferike në mes Perëndimit dhe Lindjes, bëri që ajo të mos heqë dorë shumë lehtë nga dezintegrimi i Jugosllavisë, edhe pse gjërat shkonin në atë drejtim. “BE u konfrontua me një seri të konflikteve të dhunshme të perceptuar tashmë si në “oborr” të saj dhe kishte pak kapacitete për t’iu përgjigjur krizave. Dy luftërat, ajo në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë përfunduan pas intervenimeve të NATO-s, të cilat u udhëhoqën nga Shtetet e Bashkuara”.⁴

Operacioni “Forcat Aleate” kundër ish RFJ-së nuk do të ishte ekzekutuar pa rolin prijës të SHBA-ve, por ky sinjalizoi që shumica e aleatëve evropianë ishin të vullnetshëm të përdorin ushtritë e tyre në kontinent për të parandaluar “katastrofën humanitare” siç ishte spastrimi etnik në oborrin e vet.⁵

Para luftës, ShBA ishin të orientuara në respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe për një status brenda ish Jugosllavisë.⁶ Përkundër kësaj ato patën rrol udhëheqës në angazhimet në Grupin Ndërkombëtar të Kontaktit në marrjen me krizën e Kosovës. Edhe ky grup i përmbahej qëndrimeve zyrtare të SHBA-ve lidhur me statusin.⁷

Në mars të vitit 1998, Senati Amerikan miratoi rezolutën për ngrirjen e pasurisë së shtetit Serbi-Mali i Zi. Një grup prej 36 anëtarëve të Kongresit i dërgojnë letër Presidentit Klinton me qëllim të

⁴ Abraham M. Verheij, *European Union peacebuilding in Kosovo, An analysis of dealing with peacebuilding paradoxes and engagement with civil society*, Thesis for the Masters Programme “Conflicts, Territories and Identities”, Radboud University Nijmegen, 2010, faqe 3.

⁵ Po aty faqe 24. Kryeministri i Francës Lionel Jospin, duke shpjeguar vendimin për të hyrë në luftë në mars 1999, tha: “ Derisa Këshilli i Sigurimit nuk ishte i gatshëm të veprojë, ne duhet të veprojmë në përgjegjësinë tonë”.

⁶ Steven Woehrel, *CRS Report for Congress Kosovo and U.S. Policy*, June 16, 1998, faqe 4, Robert Gelbard, shef i misionit të SHBA-ve për politika me ish Jugosllavinë, më 6 maj 1998, tha se SHBA favorizon një “status të avancuar” brenda RFJ-së i cili përfshinë “vetadministrim kuptimplotë”.

⁷ Po aty, faqe 4.

përgatitjes së NATO-s për intervenim ushtarak në Kosovë.⁸ Rezoluta 1199 e KS të KB e 23 shtatorit 1998, dhe mos përparimi në çështjet të cilat ajo i përmbante karshi Beogradit, nxiti autoritetet e SHBA-ve të deklarohen se kjo është bazë e mjaftueshme legale për intervenim ushtarak ajror të NATO-s në zgjidhjen e çështjes së Kosovës.⁹NATO, në tetor dha “urdhri aktivizues” për autorizimin e sulmeve ajrore. Manovrimi i Millosheviqit, pajtimi me kërkesat e rezolutave, pranimi i Misionit Verifikues të Kosovës dhe tërheqja e një numri të policisë dhe ushtrisë nga Kosova bëri që “urdhri” vetëm të suspendohet. Kësaj marrëveshje Millosheviq nuk iu përmbajt, përkundrazi shtoi numrin e ushtarëve për operacion edhe më të gjerë. Rezolutat e miratuara nga KS i OKB-së, 1160 kur vendoset embargo e armëve, ajo 1199, me të cilën konstatohet kërcënimi serioz për paqen në regjion, 1203, kërkesa për vendosjen e Misionit Verifikues në Kosovë për të mbikëqyrë gjendjen në terren, ishin të kota në parandalimin e objektivave të Serbisë ndaj Kosovës. U dashtë ndërhyrja ushtarake e Forcave Aleate për të ndërprerë dhunën serbe. Ndërhyrja e vendosur e NATO-s krijoi klimën për rezolutën e radhës 1244, e cila, përkundër të metave të cilat i përmban, krijoi hapësirë për vendosjen e paqes dhe nuk i mbylli dyert e ecjes drejt pavarësisë. Diskutimet lidhur me legjitimitetin e intervenimit në një shtet sovran dhe jashtë NATO-s, kishin nisur qysh në fazën e përgatitjeve për intervenim dhe vazhdojnë edhe tani, varësisht nga këndi i të shikuarit të ligjit ndërkombëtar. Por me kohë do të shuhen zërat kundërshtarë të intervenimit, ngase ky ka qenë një akt legjitim në mbrojtjen nga

⁸ Morton I. Abramowitz, Elliott Abrams, Richard L. Armitage, Nina Bang-Jensen, Jeffrey Bergner, George Biddle, John R. Bolton, Frank Carlucci, Eliot Cohen, Seth Cropsey, Dennis DeConcini, Paula Dobriansky, Morton H. Halperin, John Heffernan, James R. Hooper, Bruce P. Jackson, Robert Kagan, Zalmay Khalilzad, Lane Kirkland, Jeane Kirkpatrick, Peter Kovler, William Kristol, Mark P. Lagon, Richard Perle, Peter Rodman, Gary Schmitt, Stephen Solarz, Helmut Sonnenfeldt, William Howard Taft IV, Ed Turner, Wayne Owens, Paul Wolfowitz, Dov S. Zakheim. Në <http://www.newamericancentury.org/kosovomilosevicsep98.htm>, qasja 14 tetor 2012.

⁹ Po aty, faqe 3.

spastrimi etnik i një populli. Këta zëra vijnë nga vendet që kanë probleme me demokracinë dhe me shkeljen e të drejtave të njeriut.

Në ngritjen dhe sensibilizimin e çështjes së Kosovës gjatë viteve të 80-ta e 90-ta patën ndikim senatorët dhe kongresistët amerikanë të të dy vijave partiake,¹⁰ lobi i shqiptarëve në SHBA, veprimtaria e Këshillit Shqiptaro-Amerikan, Dega e LDK-së në SHBA, e shoqata të shumta në përkrahje të Pavarësisë së Kosovës. Miqësia me politikbërësit amerikanë, qëndrimi i qartë i politikës kosovare për miqësi të përhershme me SHBA-t dhe vizioni për përhapjen e lirisë dhe demokracisë në tërë botën nga Amerika, bënë që edhe në këtë pjesë të Evropës të vendosen fillet e demokracisë së ndaluar.

ShBA-të e Kosova, pas luftës

Pas vendosjes nën administrim ndërkombëtar, Kosova u përkrah gjithanshëm, kryesisht nga demokracitë perëndimore. Pas kësaj filloi një fazë e sprapsjes së angazhimit amerikan duke i dhënë përparësi aleatëve të saj evropianë në marrjen me çështjen e Kosovës, por pa shenja të tërheqjes së njëanshme, sepse, si do të shprehet Presidenti Bush, gjatë vizitës së tij bërë ushtarëve të KFOR-it amerikan në Bondsteel, më 24 korrik 2001, “erdhëm së bashku në Evropën Juglindore dhe do të shkojmë së bashku...kur paqja në Kosovë do të bëhet e vet-qëndrueshme”.¹¹

Ato kanë interesa lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, përfshirë ofrimin e mbrojtjes dhe drejtësisë për popullsinë shqiptare dhe serbe të Kosovës, inkurajimin e vendosjes së një qeverisjeje të re demokratike në Serbi, përmirësimin e sigurisë dhe parandalimin e

¹⁰ Dole, Lantosh, Engel, Dioguardi, Biden, Lieberman, McConell, McCain, Lugar, Hutchinson, Presler...

¹¹ Presidenti Bush në një vizitë të gjatë në Evropë do ta përdorë shprehjen e cituar. Shih në: Valdet Beqiraj, Bush speech to troops in Camp Bondsteel Kosovo, <http://kosova.org/post/Bush-speech-to-troops-in-Camp-Bondsteel-Kosovo.aspx>, qasja 19 tetor 2012. Office of the Press Secretary, June 14, 2001, Press Conference by President Bush, Prime Minister Goran Persson of Sweden. <http://georgewbush-whitehouse.archives.gov/news/releases/2001/06/20010614-1.html>, qasja 19 tetor 2012. Të njejtën e përdorë edhe në paraqitjen e tij në NATO, një ditë më parë.

trazirave në vendet fqinje, ruajtjen e kredibilitetit dhe kohezionit të NATO-s, parandalimin e precedentëve të dëmshëm dhe konsekuencave të paparamenduara, mbajtjen e marrëdhënieve të perëndimorëve me Rusinë në rrugë konstruktive dhe kufizimin e madhësisë dhe kohëzgjatjes së përkushtimit të SHBA-ve në zbatimin e një zgjidhjeje.¹²

Në dinamikën e konstelacioneve globale dhe fluiditetin e ngjarjeve të cilat paraqiten si sfida për marrëdhëniet ndërkombëtare, SHBA-të dhe demokracitë botërore janë të interesuara të “kryejnë detyrën” në Ballkan, duke e vendosur Evropën në ujëra të qetë politikë. Dhe, fillimi i paqe-ndërtimit nuk ka nënkuptuar përkrahjen për pavarësi, deri në krijimin e kushteve për t’u marrë me statusin politikë. Madeleine Albright, duke folur para Këshillit për Marrëdhënie të Jashtme, deklaroi se konfrontimi i NATO-s me Beogradin për Kosovën ka përfunduar në pajtim me kushtet e vendosura nga Aleanca. “Janë disa të cilët e shohin të pakapërcyeshme sfidën e dëshirës së shumë kosovarëve për pavarësi të menjëhershme-një pozicion të cilin NATO e as qeveritë në regjion nuk e përkrahin”,¹³ flet për pozicionin aktual dhe atë i cili mund të evoluojë në të ardhmen lidhur me Pavarësinë e Kosovës. Në këtë kohë shumë politikuaq e burrështetas qarkullonin idenë se Kosova do të mund të kthehej brenda shtetit të mëparshëm pasi që gjërat do të shkonin kah demokratizimi i Serbisë. Rugova, i pyetur lidhur me këtë në një intervistë u shpreh: “Kosova kurrë më nuk do të bëhet pjesë e Serbisë, qoft edhe nëse Millosheviqi bie.”¹⁴

Në kërkim të paqes, në shtator të vitit 1999, me kërkesë të Kryeministrit suedez, Göran Persson, u themelua Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën me qëllim të ofrimit të një analize objektive për të kaluarën, gjendjen aktuale dhe perspektivën e

¹² Francis T. Miko, *CRS Report for Congress, Kosovo's Future Status: Alternative Models*, May 26, 1999, Faqe 2-4.

¹³ *Center on Foreign Affairs, Prepared Remarks by Secretary of State Madeleine Albright*, June 28, 1999

<http://www.cfr.org/nato/prepared-remarks-secretary-state-madeleine-k-albright/p3189>, qasja 02 tetor 2012.

¹⁴ *Associated Press, "Rugova Says Kosovo Will Never Be a Part of Serbia, Even if Milosevic Ousted"*, 7 gusht 1999.

Kosovës lidhur me statusin e saj politik. Ky komision prodhoi dy dokumente, në të cilët preferoi si opsionin më të mirë atë të pavarësisë së kushtëzuar. Dokumenti i dytë¹⁵ erdhi pas ngeçjes së bartjes së kompetencave te vendorët dhe si rezultat pasoi propozimi i fazës së quajtur “ Standardet para Statusit”, nga ana e Administratorit, Michael Steiner.

Inicimi i politikës së arritjes së “ Standardeve para Statusit” nga UNMIK-u, në vitin 2002, ishte një përpjekje për të ndërgjegjësuar faktorin vendor se pa pasur suksese në fushat e caktuara nuk do të ketë përparime në përcaktimin e statusit të Kosovës, e cila ishte një përpjekje balansuese në mes të kërkesave të Kosovës për përshpejtim të bartjes së kompetencave dhe ecjes drejt statusit përfundimtar dhe asaj Serbe për të mos e bërë këtë. Administrata e Bush-it fuqishëm përkrahu këtë politikë e në vitin 2003 kërkoi që kësaj t’i jepej rëndësi më e madhe dhe të caktohet viti 2005 afati kohor për vlerësimin e të arriturave të kësaj startegjie. Në rast se Kosova përmbush standardet, bashkësia ndërkombëtare duhej përgatitur për fillimin e procesit të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, duke shtuar se të gjitha opsionet ishin në tavolinë. Pakënaqësitë e lartpërmendura por edhe tendencat e grupimeve politike për ta paraqitur punën e institucioneve si shterpë, rezultuan edhe me ngjarjet e marsit 2004, të cilat administrata e SHBA-ve i dënoi dhe kërkoi kthimin e qetësisë.

Duke hetuar se zhvillimi i ngjarjeve në Kosovë, sidomos ngurrimi për të bartur kompetencat te vendorët, paaftësia për të ndërtuar sistem unik të qeverisjes në tërë Kosovën, se shtyrja e përcaktimit të statusit përfundimtar është politikë shterpë dhe e paqëndrueshme, nismat e politikës amerikane janë përsëri ato të cilat filluan të shtyjnë procesin përpara. Grupi i Quintit, (ShBA, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia), pas “ftohjes” nga intervenimi i vitit 1999, me qëllim të afrimit më të lehtë të zgjidhjes së problemit të Kosovës,

¹⁵ Antarët e komisionit ishin Richard Goldstone, kryetar, Afrika e Jugut, Carl Tham, zëvendës Kryesues Suedi, antarë: Gråce d’Almeida, Hanan Ashrawi, Akiko Domoto, Richard Falk, Oleg Grinevsky, Michael Ignatieff, Mary Kaldor, Martha Minow, Jacques Rupnik, Theo Sommer, Jan Urban dhe ekipa përkrahëse. Shih në http://www.kulturserver-hamburg.de/home/illyria/kosovocommission.org_report_english_2001.pdf, qasja 12 tetor 2012.

ishte i interesuar të bashkëpunojë me Rusinë, nëpërmjet Grupit të Kontaktit i cili në vitin 2005 deklaroi parametrat lidhur me statusin final të Kosovës: Kosova nuk duhet të kthehet në gjendjen e para vitit 1999, nuk do të ndahet, apo nuk do të formojë union me ndonjë shtet tjetër,¹⁶ të cilat propozime ishin bërë edhe nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave,GNK, në raportin e vitit 2005.¹⁷

Në dëshminë para Komitetit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kongresit, në maj 2005, nën Sekretarinë e Shtetit, Nicholas Burns, nisi një politikë të re “të kryerjes së detyrës” në regjion. Në koordinim me KB dhe Grupin e Kontaktit, SHBA-të sforcojnë idenë se viti 2005 ishte “vit i vendimit” për Kosovën, duke nënkuptuar që SHBA-t kërkojnë nisjen e procesit për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Deri te ky përfundim vihet pasi që siguria lidhur me statusin u pa se ishte jo e qëndrueshme duke lënë të hapur mundësinë për përsëritjen e dhunës etnike, e cila do të zbrapste sukseset e SHBA-së dhe aleatëve në Ballkan në ndërtimin e paqes dhe vendosjen e rendit e ligjit demokratik në dekadën e fundit në regjion. Marrëveshja e arritur do të zbatohet me ndihmën e prezencës civile dhe ushtarake ndërkombëtare, e në këtë drejtim SHBA-të do të dëshironin që ky rol të merrej nga BE-ja, në të cilën përkrahje Shtetet e Bashkuara do të jenë partner aktiv.¹⁸

Kongresi dhe Senati Amerikan do të jenë shumë aktivë në atë kohë. Në Kongresin e 109 çështja e statusit të Kosovës do të zë vend të konsiderueshëm. Disa prej anëtarëve të Kongresit¹⁹ insistuan në pavarësinë e Kosovës sa më shpejt që është e mundur, e disa konsideronin se para kësaj duhet arritur disa nga standarde. Tom Lantos, në vitin 2005, propozoi rezolutën (H.Res.24) me të cilën

¹⁶ *Guiding Principles of the Contact Group for a Settlement of The Status of Kosovo*, në: www.unosek.org/docref/Contact%20Group%20%20Ten%20Guiding%20principles%20for%20Ahtisaari.pdf, pika 6. qasja 13 gusht 2012.

¹⁷ Këto sugjerime jepen në pikën 1b të rekomandimeve të GNK. Shih në: <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/161-kosovo-toward-final-status.aspx>, qasja 12 gusht 2012.

¹⁸ Më gjerësisht shih në: <http://www.state.gov/p/us/rm/2005/46471.htm>, qasja 23 gusht 2012.

¹⁹ Shih më shumë në: Steven Woehrel, *CRS Report for Congress Updated, January 9, 2006, Kosovo's Future Status and U.S. Policy*.

kërkohej që SHBA të përkrahë pavarësinë e Kosovës. Në shtator 2005, Senati nxori Rezolutën (S.Res. 237), e cila kërkonte angazhimin amerikan në arritjen e marrëveshjes për statusin e ardhshëm të Kosovës, i cili do të kënaqte brengat kyçe të popullit të Kosovës dhe Serbisë e Malit të Zi. Ambasadori norvegjez në NATO, Kai Aarde, i dërguar i SP të KB për të vlerësuar progresin e arritur në Kosovë lidhur me përmbushjen e standardeve, në raportin e tij të dytë, i propozon Sekretarit të Përgjithshëm se procesi për statusin e ardhshëm të Kosovës duhet të fillojë.²⁰

Në dhjetor 2005, Administrata Amerikane emëroi Ambasadorin, Frank Wisner, përfaqësues special të Sekretarit të Shtetit për bisedime për statusin e Kosovës, derisa Rusia çdoherë sfidoi përditësimin në lehtësimin e pavarësisë së saj. Në opinion, gjatë vitit 2006, Grupi i Kontaktit ishte përpjekur të lë të hapur statusin final të Kosovës, por joformalisht SHBA-të dhe aleatët e saj u kanë thënë dy palëve se ata do të propozojnë pavarësinë këtë vit.²¹ Grupi i Kontaktit, vendosi kornizat brenda të cilave do të gjindej zgjidhja, në mes tjerash ajo e moskthimit në kohën e para ndërhyrjes së NATO-s, ajo e cila do të kënaqte aspiratat e popullit të Kosovës dhe mosndryshim të territorit të Kosovës. “Pas një viti negociatash në mes Serbisë dhe Kosovës, Kremli i Presidentit Vladimir Putin hodhi raportin e ndërmjetësit të KB, Ahtisaari, i cili rekomandonte pavarësi të mbikëqyrtur, pengoi Këshillin e Sigurimit nga pranimi i raportit dhe insistoi në tre muaj shtesë të negociatave në mes Serbisë e Kosovës, që edhe pas tyre kompromisi rezultoi të ishte i pamundur”.²²

Pas shpalesjes së Raportit të Ahtisaarit, në mbledhjen G-8-ës, në Gjermani më 6-8 qershor 2007, u pranua propozimi befasues i Presidentit francez, Nicolas Sarkozy, për shtyrjen e bisedimeve edhe për katër muaj, në kërkim të gjetjes së zgjidhjes dhe përkrahjes së

²⁰ Letter dated 7 October from Secretary-General addressed to the President of the Security Council, UN Doc.S/2005/635, 7 tetor 2005.

²¹ Morton Abramowitz and James Lyon, *Another Balkan high noon*, në <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2006/oct/24/anotherbalkanhighnoon>, qasja 27 gusht 2012.

²² Morton Abramowitz, *Putin's Balkan mischief*, intervistë për *The Guardian*, 28 Janar 2008 në <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2008/jan/28/putinsbalkanmischief>, qasja 17 shtator 2012.

Rusisë, e cila megjithatë nuk do t'i bashkohet G-8-ës, duke e konsideruar atë si "kurth - mbulojë" për përkrahjen automatike të dokumentit të Ahtisaarit pas kalimit të afatit 120-ditorë".²³

Edhe pas rundit të dytë të negociatave, pasi që Serbia synonte të fuste në diskutim propozimin e saj për autonominë e Kosovës brenda saj por me kompetenca dhe simbole të cilat ishin të rezervuara për shtetet sovraane,²⁴ pozicionet e të dy palëve "ishin shumë larg njëri-tjetrit".²⁵

Pas publikimit të Propozimit Gjithpërfshirës për Statusin e Kosovës nga ana e ish Presidentit Finlandez Marti Ahtisaari, Administrata e ShBA-ve e përkrahu atë duke e konsideruar si të drejtë dhe të balancuar, i cili do të jetë bazë për një Kosovë stabile, prosperuese dhe multietnike, duke ftuar dy palët për angazhim në pranimin e planit. Në këtë drejtim, e njëjta kishte angazhuar nxitjen e Serbisë për të ndjekë rrugën drejt BE-së dhe ofrimit me NATO-n, duke i ofruar programin e Partneritetit për Paqe si dhe në unifikimin e faktorit ndërkombëtar rreth statusit. Duke e parë se Rusia nuk ishte në të njëjtat valë, Bush, gjatë vizitës së tij në Itali dhe Shqipëri në qershor 2007, do të shprehet se "tani është koha" dhe se fundi i procesit do të jetë pavarësia e Kosovës bazuar në planin e Ahtisarit, përkundër pranimit për biseda shtesë katërmuajshe. Rusia kërkoi që çdo marrëveshje për Kosovën duhet të marr pëlqimin e Serbisë dhe angazhohej për vazhdimin e negociatave, të cilat do të mund të shkonin në pafundësi. Ajo, Rusia, kishte qëllim futjen e ndasive në mes aleatëve perëndimorë apo siç shprehet Bugajski, "pengoi politikat e aleancës për dy arsye: të rrisë prestigjin e saj dhe të ndikojë në

²³ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar, Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë, Koha, 2009, faqe 364-5.

²⁴ Presidenti i Serbisë Tadiq, ofron Kosovës qasje në institucionet financiare ndërkombëtare (jo në OKB, OSBE,KE), flamurin, himnin, përfaqësimin sportiv jashtë Kosovës, etj. Shih në Marc Weller, po aty, faqe 372.

²⁵ Shih në Raporti i Misionit të Këshillit të Sigurimit për qështjen e Kosovës, *UN Doc.S/2007/256*, i datës 4 maj 2007, paragrafi 59.

Ballkan, si dhe të dobësujë kredibilitetin e projektuar të misioneve të reja të NATO-s në Evropë”.²⁶

Në këtë drejtim në prag të shpalljes së pavarësisë së shtetit të Kosovës, i dërguari special amerikan, Frank Wisner, lidhur me konsekuencat²⁷ e shpalljes së pavarësisë tha që “gjërat mirë të bëra, situata politike e qartësuar dhe ecja e Kosovës me jetën e vet”, janë tri konsekuenca pozitive të ngjarjes e cila do të pasojë brenda javës. Se si do të reagojë Rusia ndaj përkrahjes së deklaratës në ardhje të pavarësisë, Abramowitz thotë se kjo “do të testojë se sa larg ka ecur progresi që nga Lufta e Ftohtë. Nëpërmjet menaxhimit të kujdesshëm të procesit të pavarësisë dhe vëmendjes për mundësitë për të përmirësuar raportet me Rusinë, perëndimi mund t’i zbusë konsekuencat e këqija të këtij konfrontimi. Sa i përket Luftës së re të Ftohtë, mund të jetë pak më e butë”.²⁸ Lidhur me ndikimin rus të cilin mund ta ketë në periudhën e pas deklaratës të pavarësisë, Holbrooke, mendon se “kësaj here Moska nuk ka ndihmuar fare, duke inkurajuar kokëfortësinë serbe dhe mosgatishmërinë për të punuar në gjetjen e marrëveshjes për t’i lejuar Kosovës një tranzicion paqësor drejt pavarësisë, e cila ishte e premtuar nga komuniteti ndërkombëtar”.²⁹

Meqë nuk ishin krijuar kushtet për ta miratuar Marrëveshjen Ahtisaari në KS të KB, pas dështimit edhe të raundit të dytë të bisedimeve në mes të delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë, pas një koordinimi me demokracitë perëndimore, Kosova, më 17 shkurt 2008, shpalli Pavarësinë e saj. Administrata e SHBA-ve³⁰ dhe shumica e

²⁶ Janusz Bugajski, *Facing The Future: The Balkans To The Year 2010*, Center for European Integration Studies Rheinische Friedrich Wilhelms-Universität Bonn, Discussion Paper D 86, 2001. Faqe 17.

²⁷ Frank Wisner, *Russian Opposition to Kosovo Independence 'Unbelievably Regrettable'*, February 12, 2008, në <http://www.cfr.org/kosovo/wisner-russian-opposition-kosovo-independence-unbelievably-regrettable/p15483>, qasja 11 gusht 2012.

²⁸ Morton Abramowitz, po aty.

²⁹ Richard C. Holbrooke, *Kosovo Independence Declaration Could Spark Crisis*, intervistë për The Council on Foreign Relations, December 5, 2007, në <http://www.cfr.org/kosovo/holbrooke-kosovo-independence-declaration-could-spark-crisis/p14968>, qasja 7 janar 2012.

³⁰ <http://georgewbush-whitehouse.archives.gov/news/releases/2008/02/20080218-3.html>. qasja 12 shtator 2012.

vendeve të BE-së, zyrtarizuan njohjet formale të Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur një ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Përveç protestave të dhunshme në Serbi ndaj ambasadave perëndimore dhe dy pikave kufitare me Kosovën, nuk pati akte të tjera të dhunshme. Bazuar në informatat e Drejtorit të Inteligjencës Nacionale të SHBA-ve të ofruara para Komitetit të Senatit, "Uashingtoni ka informatë të mirë se Qeveria e Serbisë ka urdhëruar policinë që mos të ndërhyjë ndaj protestuesve të cilët sulmuan ambasadat".³¹ Nisur nga obstrukcionizmi serb, parlamenti i së cilës e anuloi deklaratën e pavarësisë dhe përkrahja nga vendet të cilat kanë probleme të brendshme etnike të pazgjidhura dhe me qëllim të pengimit të njohjeve nga shtetet e tjera, Serbia, më 15 gusht 2008, zyrtarisht pranë OKB-së kërkoi opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. GjND, lidhur me atë se "a e ka shkel ligjin ndërkombëtar shpallja e pavarësisë nga ana e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës?" Kjo i mori dy vite kohë diplomacive të vendeve të cilat hezitonin por edhe të tjerëve, për njohjen e shtetësisë së Kosovës. Reflektimi i GjND-së ishte bumerang³² për parashtruesit e pyetjes dhe atyre të cilët e përkrahën në këtë drejtim. Me rastin e vizitës së tij në Kosovë, nënpresidenti amerikan, Joseph Biden, më 21 maj 2009, deklaroi se "suksesi i Kosovës së Pavarur është një prioritet i ShBA-ve".³³

Përfundim

Përkrahja amerikane për Kosovën duhet shikuar si përkrahje globalizimit të demokracisë dhe respektimit të identitetit individual e kolektiv e si përpjekje për t'i ndalë tiranitë e autokratëve në vendet me deficit demokratik. Ajo kishte nisur me qitjen në pah të sjelljeve

³¹ <http://www.voanews.com/english/news/a-13-2008-03-07-voa19-66744437.html>, qasja 12 shtator 2012.

³² Shih në këtë punim: Opinonet lidhur me qëndrimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me legalitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës të iniciuar nga Beogradi.

³³ Teksti i fjalimit të Bajdenit në: http://www.whitehouse.gov/the_press_office/Remarks-By-The-Vice-President-To-The-Assembly-Of-Kosovo/, qasja 19 shtator 2012.

përbuzëse të regjimit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë, me përkrahjen humanitare e ekspertizë, me kontributin e saj gjatë ndërhyrjes ushtarake për ta ndalur eksodin e popullsisë, e pas luftës duke e ndihmuar atë në ngritjen e institucioneve demokratike, në zhvillimin ekonomik e asistim në tejkalimin e ngërçeve politike të paraqitura si pasojë e brishtësisë së institucioneve të Kosovës së pasluftës. Politika e ShBA-ve ndaj Kosovës përfshinë përkrahjen në respektimin e të drejtave të njeriut deri te vetëvendosja për popullin e Kosovës.

Bibliografia:

Bashkurti, Lisen. *Negociatat, historia, teoria, praktika*, Tiranë: GEER, 2007.

Bugajski, Janusz. *“Western Balkans Policy Review 2010”*, Center for Strategic & International Studies, 2010.

Bugajski, Janusz. *“Facing The Future: The Balkans To The Year 2010”*, Center for European Integration Studies

Rheinische Friedrich Wilhelms-Universität Bonn, Discussion Paper D 86, 2001.

Dalipi, Samet. *“Ndërtimi i paqes në Kosovë nga perspektiva e politikolgjisë amerikane”*, doctoral thesis,

International University of Struga, 2012.

Marc Weller. *Shtetësia e kontestuar, Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë:

Koha, 2009.

Miko, Francis T. *“CRS Report for Congress, Kosovo’s Future Status: Alternative Models”*, May 26, 1999.

Poulain, Luic & Teleki, Ilona. *“U.S. Policy Toward the Western Balkans”*, at ed. Janusz Bugajski, *“Western*

Balkans Policy Review 2010”.Center for Strategic & International Studies, 2010.

Verheij, Abraham M. *“European Union peacebuilding in Kosovo, An analysis of dealing with peacebuilding*

paradoxes and engagement with civil society", 30 October 2010, Thesis for the Masters Programme "Conflicts,

Territories and Identities", Radboud University Nijmegen, 2010.

Woehrel, Steven, "CRS Report for Congress Kosovo and U.S. Policy", June 16, 1998.

Woehrel, Steven, "CRS Report for Congress Kosovo's Future Status and U.S. Policy", Updated January 9, 2006.

Associated Press, "Rugova Says Kosovo Will Never Be a Part of Serbia, Even if Milosevic Ousted", August 7

1999.

Letter dated 7 October from Secretary-General addressed to the President of the Security Council, UN

Doc.S/2005/635, October 7, 2005.

"SC Mission Report on Kosovo issue", UN Doc.S/2007/256, 4 May 2007.